



Republika E Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	03.10.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shënjë		
		01-370/01-25228/25		

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Z/ Izahir Kuka,(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Mali Art Group" Shpk, nga Kaçanik i Vjeter përfaqësuar nga Muhamet Berisha nga Kaçanik i Vjeter (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike-projekt dyvjeçar

me numër identifikues: **652-24-7879-5-2-1**

KA652/25/049/521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike – Projekt dyvjeçar

në < sipas dosjes > pjesë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është **249.206,18€** dhe me fjalë

(Dyqindëekatërdhjetëenëntëmijëeddyqindëegjashtëeuro 18/100 centë),

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Kushtrim Misini

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muhamet Berisha	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	Menagjer	Pozita:	u.d. Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.10.2025	Data:	10/10/2025
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorpuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilitdo njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës

që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikën, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e faktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të caktuar në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe Parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me

parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumat e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumat që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shumat proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohej nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shumat totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostojat e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimi të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftojë Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryejë të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimi të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshojë Certifikatën e pranimi të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të japë instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimi të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshojë Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikojë cilëndë pagese finale e cila duhet të paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimi të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë

apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas riorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendosë mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij

vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat] ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat] ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat] ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: <i>Hajredin Shehu</i> ndërsa mbikqyrës të drejtëpërdrejtë janë: <i>Visar Mulaku dhe Shkodran Sopa</i>
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej 06.10.2025 ku e gjith plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 05.10.2027
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë (një vit) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 %) për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.

Kushtet e pagesës	20.1	Kushtet e pagesës janë: Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 24,920.61€
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është 10% .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, në rast se nuk zgjidhet në mënyrë miqësore kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komunale Kaçanik b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.

PARAMASA					
E PUNËVE PËR NDËRTIMIN E KANALIZIMIT FEKAL DHE ATMOSFERIK - KAÇANIK					
Nr	EMËRTIMI I POZICIONEVE	Njësia	Sasia e planifikuar	Çmimi njësi me TVSH	Totali
I	PUNET PARAPRAKE				
	Punët për ripërtirjen e pikave të nevojshme gjeodezike, matjet dhe inqizimet e trasës, largimi i rrethojave, gardheve etj. Këtu nënkuptohet transporti i mekanizmave të nevojshëm deri në vendpunishte për fillimin e punëve të kanalizimit.				
1	Llogaria bëhet për m'.	m'	9400.00	0.20	1,880.00
				Gjithsejt:	1,880.00
II	PUNET E GERMIMIT				
	Gërmimi i dheut të kategoris së III dhe IV për ndërtimin (hapjen) e kanalit me makineri dhe dorë për punimi e rrjetit të kanalizimit. Llogaria të				
1	bëhet për m ³ të dheut të gërmuar.	m ³			
1.1	-me makineri 80%	m ³	10659.60	2.80	29,846.88
1.2	-me dorë 20%	m ³	2664.90	3.50	9,327.15
	Transporti (largimi) i dheut të tepërt deri në deponin e caktuar më parë nga organi mbikqyrës me largësi deri L=7.0km.				
2	Llogaria bëhet për m ³	m ³	1504.00	1.20	1,804.80
	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë (pas gërmimit të kanalit me makineri) deri në pjertësin e kërkuar sipas projektit dhe e njëjta të kontrollohet me nivelmatës.				
3	Llogaria të bëhet për m ² .	m ²	6580.00	1.20	7,896.00
	Sigurimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së rërës së paseperuar apo materialit I cili l plotëson kushtet për planifikim të kanalit, përgaditjes së bazës për montimin e gypave 10 cm, anash gypit dhe mbi gyp me trashësi 20 cm. Materiali i cili do të përdoret paraprakisht duhet të mirret pëlqimi nga organi mbikqyrës.				
4	Llogaria bëhet për m ³ .	m ³	1504.00	3.00	4,512.00
	Sigurimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit me makineri dhe dorë të paseperuar me fraksion 0-31.5 mm nëpër pozicionet e kërkuara për kompletim të pozicionit. Në llogari hynë edhe ngjeshja e saj në shtresa 30 cm deri në modulën e kërkuar.				
5	Llogaria të bëhet për m ³ .	m ³	1250.00	10.00	12,500.00

6	Sigurimi,transporti dhe shtrirja e zhavorit me makineri dhe dorë të paseperuar me fraksion 0-63 mm në pozicionet e kërkuara për kompletim të pozicionit. Në llogari hynë edhe ngjeshja e saj në shtresa 30 cm deri në modulën e kërkuar Llogaria të bëhet për m³.	m³	1250.00	10.00	12,500.00
7	Sigurimi dhe shtrirja e shiritit sinjalizues me mbishkrim "kanalizim". Shtrirja e shiritit bëhet 30-40cm mbi gyp. Llogaria bëhet për m'.	m'	9400.00	0.15	1,410.00
8	Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar (pas montimit të gypave) në shtresa prej 30-40 cm dhe të njëjtat të ngjeshen me vibrator bretkocë.Mbulimi i kanalit të bëhet në atë mënyrë tereni të kthehet si në gjendjen e mëparshme. Llogaria të bëhet për m³.	m³	11350.50	1.50	17,025.75
9	Zgjerimi,planifikimi dhe gërmimi i dheut me dorë në vendet ku është paraparë të punohen pusetat reviduese sipas projektit.Në llogari hynë edhe transporti i dheut të gërmuar deri në deponin e caktuar më parë. Llogaria të bëhet për m³ dhe të të gërmuar.	m³	648.00	1.50	972.00
10	Largimi i ujrave nëntokësor me pompë nëse ato paraqiten.Llogaria të bëhet për 1orë efektive të punës së pompës të cilën duhet ta përcjell dhe miratoj organi mbikqyrës.	orë	60.00	1.50	90.00
			Gjithsejt:		97,884.58

III	PUNET LATUESE				
1	Sigurimi,dhe përforcimi i mureve anësore të kanalit (skarpateve) nga shembja, me gjatësi l=20m dhe të njëjtat mund të përdoren 10 herë.Sigurimi dhe përforcimi i kanalit të bëhet sipas detalit të treguar. Llogaria të bëhet për m².	m²	200.00	0.50	100.00
			Gjithsejt:		100.00

IV	PUNET E BETONIT				
-----------	------------------------	--	--	--	--

1	Sigurimi, transporti dhe montimi i elementeve të parafabrikuara me mbarim konus nga materiali i betonit për punimin e pusetave reviduese me prerje terthore rrethore me diametër Ø 800mm. Në llogari hynë edhe punimi i fugave ndërmjet elementeve me llaq të qimentos. Llogaria bëhet për m' të pusetës	m'	230.00	55.00	12,650.00
2	Sigurimi, transporti dhe montimi i elementeve të parafabrikuara me mbarim konus nga materiali i betonit për punimin e pusetave reviduese me prerje terthore rrethore me diametër Ø 1000mm. Në llogari hynë edhe punimi i fugave ndërmjet elementeve me llaq të qimentos. Llogaria bëhet për m' të pusetës	m'	70.00	60.00	4,200.00
3	Punimi - nivelizimi (ngritja e kapakëve të pusetave me nivelin e rrugës) i bazës së kapakëve të pusetave nga materiali i betonit të armuar me trashësi të pllakës d= 15 cm min. Dimensionet e pllakës janë 120x120x15 cm. Armimi të bëhet me armaturë rrjetë Q-335 Mpa. Betonimi të bëhet në bazën më parë të pregaditur nga zhavori i ngjeshur. Llogaria bëhet për copë .	copë	60.00	20.00	1,200.00
4	Punimi dhe ndërtimi i kinetave të pusetave reviduese nga materiali i betonit C-25/30 Mpa me tashësi d=20 cm duke i dhënë ramjen e duhur dhe lëmuarjen e saj deri në shkëlqim. Llogaria bëhet për copë.	copë	250.00	10.00	2,500.00
5	Punimi i kanaleve të hapura atmosferike, dhe pusetave monolite nga materiali i BA-së me beton të klasës C-25/30 Mpa dhe qelikut S-400/500 Mpa. Në këtë pozicion nënkuptohen të gjitha nënpozicionet e nevojshme për kompletim të pozicionit. Punimi i kanalit dhe pusetave monolite të bëhet sipas vizatimit dhe detalit të treguar. Llogaria bëhet për m³ të BA- së.	m³	25.00	35.00	875.00
6	Sigurimi i materialit dhe punimi i kokave hyrese dhe dalese (per rrjet te kanalizimit atmosferik) me beton të klasës C-25/30 Mpa dhe armaturës Q-335 Mpa sipas detalit te treguar. Ne llogari hynë: punet e germimit dhe largimit te dheut, punet e pahive, punet e betonit, punet e armatures dhe te gjitha nenpozicionet tjera per kompletim te pozicionit kryesor. Llogaria behet per kokë te punuar.	copë	10.00	25.00	250.00
			Gjithsejt		21,675.00

V	PUNET MONTUESE				
	Sigurimi dhe montimi i gypave të kanalizimit fekal nga materiali HDPE-të SN8 brinjëzuar te klasit te I-re.Gypat të montohen sipas normave dhe kushteve teknike të egzekutimit dhe tu ipet pjertësia e projektuar dhe e njëjta të kontrollohet aty për aty me nivelë.				
1.1	-Gypa HDPE, SN8 Ø160 mm te brinjezuar	m'	450.00	3.20	1,440.00
1.2	-Gypa HDPE, SN8 Ø200 mm te brinjezuar	m'	1750.00	4.90	8,575.00
1.3	-Gypa HDPE, SN8 Ø250 mm te brinjezuar	m'	4250.00	6.90	29,325.00
1.4	-Gypa HDPE, SN8 Ø315 mm te brinjezuar	m'	2550.00	10.80	27,540.00
1.5	- Gypa HDPE, SN8 Ø400 mm te brinjezuar	m'	250.00	16.70	4,175.00
1.6	- Gypa HDPE, SN8 Ø500 mm te brinjezuar	m'	150.00	21.50	3,225.00
	Sigurimi dhe montimi i kapakëve Ø700mm nga materiali i gizës së derdhur me mekanizëm për hapje dhe mbyllje në bazën prej betoni të armuar (unazës) me aftësi mbajtëse 25t.Montimi i kapakëve të bëhet sipas detalit të treguar. Llogaria				
2	bëhet për copë.	copë	70.00	60.00	4,200.00
	Sigurimi dhe montimi i kapakëve Ø700mm nga materiali i gizës së derdhur me mekanizëm për hapje dhe mbyllje në bazën prej betoni të armuar (unazës) me aftësi mbajtëse 40t.Montimi i kapakëve të bëhet sipas detalit të treguar. Llogaria				
3	bëhet për copë.	copë	40.00	60.00	2,400.00
	Sigurimi dhe montimi i kapakëve Ø800 nga materiali i kompozit me mekanizëm për hapje dhe mbyllje në bazën prej betoni të armuar (unazës) me aftësi mbajtëse 40t.Montimi i kapakëve të bëhet sipas detalit të treguar.				
4	Llogaria bëhet për copë.	copë	15.00	60.00	900.00
	Sigurimi dhe montimi i kapakëve nga materiali i betonit të armuar me diametër Ø700mm, trashësi d=10cm.				
5	Llogaria të bëhet për copë	copë	160.00	10.00	1,600.00
	Sigurimi dhe montimi i shkallëve prej shufrave të qelikut Ø 25 mm në distancë h=30cm sipas detalit të treguar.				
6	Llogaria bëhet për copë.	copë	400.00	0.10	40.00
				Gjithsejt:	83,420.00

VI	PUNËT E RRUGËS DHE NËNKALIMIT	
----	-------------------------------	--

	Prerja e shtresës së asfaltit me frezë për hapjen e kanalit. Në llogari hynë edhe transporti i asfaltit të prerë deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës.				
1	Llogaria bëhet për m'	m'	400.00	1.10	440.00
	Largimi i betoneve të ndryshme nëpër trasë të kanalit me makineri adekuate (eskavator qekiq) së bashku me largim të tij. Llogaria bëhet për orë efektive të eskavatorit qekiq.	orë ef.	20.00	35.00	700.00
2					
3	Shpimet për nënkalinim e rrugëve të asfaltuara (hekurudhave dhe pengesave të ndryshme) me makineri adekuate për kalimin e rrjeteve të kanalizimeve. Diametri i shpimeve të jetë Ø400mm. Në llogari hynë të gjitha nënpozicionet e nevojshme për kryerjen e pozicionit komplet. Në llogari hynë edhe montimi i gypit të qelikut me diametër Ø400mm.	m'	35.00	20.00	700.00
4	Punimi i kapakëve të pusetave në rrugë, ku përfshihet punimi i pllakës së betonit me dimensione 1.20x1.20x0.15m e cila punohet së bashku me kapkun metalik nga giza me aftësi mbajtëse deri në 40ton (punohen si të gatshme dhe vetëm montohen në punishte), në cmim përfshihen punët e prerjes së asfaltit apo demolimit, nivelizimi me zhavor, ngjeshja, montimi i pllakës BetonArme të përgatitur, llyerja me emulsion dhe punimi i shtresës së asfaltit AB11 t=4cm për nivelizim me rrugë.	copë	25.00	120.00	3,000.00
			Gjithsejt:		
			4,840.00		


VII	PUNET E KANALIZIMIT ATMOSFERIK				
1	Punimi i kanaleve të hapura të kanalizimeve atmosferike përgjatë trupit të rrugës me makineri dhe dorë me dimensione standarde duke iu përshtatur kushteve të terrenit. Pjertësia e skarpateve të jetë 1:1.5 ndërsa fundi i kanalit të ketë sipërfaqen e rrafshët dhe me pjertësi në kufijt e lejuar. Në llogari hynë edhe largimi i dheut të gërmuar deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës.	m'	300.00	1.50	450.00
	Llogaria bëhet për m'				

2	Sigurimi, transporti dhe montimi i i gypave nga materiali i betonit t me diametër Ø600mm me qafë nga betoni i klasës C-30/37 Mpa për punimin e kanalizimit atmosferik. Montimi i gypave të bëhet konform standardeve ndërtimore dhe kodit të ndërtimit dhe mbrenda pjertësive të lejuara. Në llogari hynë edhe punimi i fugave me llaç të çimentos. Llogaria bëhet për m'	m'	60.00	20.00	1,200.00
3	Sigurimi, transporti dhe montimi i i gypave nga materiali i betonit me diametër Ø800mm me qafë nga betoni i klasës C-30/37 Mpa për punimin e kanalizimit atmosferik. Montimi i gypave të bëhet konform standardeve ndërtimore dhe kodit të ndërtimit dhe mbrenda pjertësive të lejuara. Në llogari hynë edhe punimi i fugave me llaç të çimentos. Llogaria bëhet për m'	m'	100.00	35.00	3,500.00
4	Sigurimi, transporti dhe montimi i i gypave nga materiali i betonit të armuar me diametër Ø1000mm me qafë nga betoni i klasës C-30/37 Mpa për punimin e kanalizimit . Montimi i gypave të bëhet konform standardeve ndërtimore dhe kodit të ndërtimit dhe mbrenda pjertësive të lejuara. Në llogari hynë edhe punimi i fugave me llaç të çimentos. Llogaria bëhet për m'	m'	80.00	45.00	3,600.00
5	Sigurimi dhe montimi i kapakëve të shimbledhësve nga materiali i gizës së derdhur në bazën e betonit me aftësi mbajtëse m=25t me dimensione 395*395 mm. Llogaria bëhet për copë	copë	60.00	40.00	2,400.00
6	Punimi i pusetave të shimbledhësve nga materiali i gypave të brinjëzuar HDPE me diametër Ø400mm. Në këtë pozicion hynë: punët e gërmimit, punimi i kinetës, kyqja në rrjetin e kanalizimeve, sigurimi dhe montimi i gypit të pusetës Ø400mm (max h= 1m), punimi i bazës së kapakut nga betoni etj. Llogaria të bëhet për copë.	copë	50.00	25.00	1,250.00
7	Sanimi- zhbllokimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe kanalizimit fekal nga materiali i deponuar me makineri adekuate - kamion bot me presion dhe mekanizma adekuat mekanik për funksionalizimin e rrjetit dhe kompletimit të pozicionit. Llogaria bëhet për m'	m'	400.00	1.10	440.00

8	Pastrimi i pusetave të kanalizimit fekal me dorë dhe mekanizma adekuat mekanik. Në llogari hynë edhe largimi i materialit të pastruar. Llogaria bëhet për copë.	copë	180.00	10.00	1,800.00
9	Pastrimi i pusetave të kanalizimit atmosferik dhe pusetave të shimbledhësave me dorë dhe mekanizma adekuat mekanik. Në llogari hynë edhe largimi i materialit të pastruar. Llogaria bëhet për copë.	copë	180.00	10.00	1,800.00
10	Kositja e barnishteve dhe prerja e shkurreve me mekanizma adekuat nëpër skarpitet e lumenjve dhe prrrockave . Këtu nënkuptohet: largimi i materialit të kositur dhe prerë deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës. Llogaria bëhet për m²	m²	4023.30	2.00	8,046.60
11	Mbështjellja e gypave (Ø250-Ø315mm) të kanalizimeve fekale në pozicione specifike (nëpër ura, përrocka , shtretër të lumenjve etj) me murim nga gurë të thyer dhe beton hidroteknik me qëllim të mbrojtjes të gypit nga dëmtimet e jashtme. Llogaria të bëhet për m'	m'	120.00	30.00	3,600.00
12	Sanimi dhe punimi i skarpateve të muratuara nga guri natyral i thyer, të lumenjve dhe përrockave nga materiali i gurit të thyer me trashësi d=25 cm me strukturë të ngjashme me atë ekzistuese. Në llogari hynë : punët e murimit, punët e gërmimit , punimi i fugave, sigurimi dhe transporti i gurëve,punët e nivelizimit, zhavorit etj. Llogaria bëhet për m²	m²	150.00	20.00	3,000.00
13	Pastrimi i kanaleve të hapura, shtretërve të lumenjve,përrockave, kanaleve të rregulluara-punuara, shtretërve të kanaleve atmosferike të rrjetit të kanalizimit atmosferik nga materiali i deponuar me makineri dhe dorë. Këtu nënkuptohet largimi i materialit të deponuar, ngarkimi me makineri dhe dorë, dhe transporti i materialit i tij deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës me largësi deri 7km. Llogaria bëhet për m³ të materialit të larguar.	m³			
13.1	me makineri 80%	m³	5200.00	1.15	5,980.00
13.2	me dorë 20%	m³	1300.00	1.80	2,340.00
Gjithsejt:					39,406.60

REKAPITULLIM			
I	PUNËT PARAPRAKE		1,880.00
II	PUNËT E GËRMIMIT		97,884.58
III	PUNËT LATUESE		100.00
IV	PUNËT E BETONIT		21,675.00
V	PUNËT MONTUESE		83,420.00
VI	PUNËT E RRUGËS DHE NËNKALIMIT		4,840.00
VII	PUNËT E KANALIZIMIT ATMOSFERIK		39,406.60
SHUMA TOTALE:			249,206.18

Mali Art Group SH.P.K.
18.09.2025, Kaçanik



Vërejtje: Para fillimit të punimeve , punëkryesi është i obliguar që të njoftojë me shkrim Keds-in, PTK-n, Ipko-n dhe KRU "Bifurkacioni" që të identifikojnë rrjetet dhe infrastrukturën nëntokësore me qëllim të evitimit nga dëmtimet e mundshme gjatë zhvillimit të punimeve, dhe për çdo dëmtim punëkryesi i bart obligimet financiare dhe është i obliguar që ti riparoj defektet e mundshme dhe ti kthej terenin si në gjendjen e fillestare. Materiali i përdorur të jetë i klasës së I-rë me mbishkrim të prodhuesit dhe ti plotësoj kriteret sipas standardeve.

Punëkryesi nuk guxon në asnjë mënyrë të mbulojë gypat e montuar pa lejen e organit mbikqyrës dhe është i obliguar që për çdo material të përdorur të siguroj atestat mbi klasën dhe cilësinë e materialit.

Kaçanik, Gusht 2025

E Punuar:
DSHPE



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01 Nr. 370/01-25228
Kaçanik 03.10.2025

Në bazë Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të
Rregullores 001/2022 Për Prokurimi Publik nenit 70 , Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT
TË DREJTËPËRDREJTË

I. Me këtë vendim emërohet Menaxher i projektit **Hajredin Shehu dhe mbikqyrës të drejtëpërdrejtë, Visar Mulaku dhe Shkodran Sopa** në Projektin: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike** në bazë të Kontratës **01Nr.370/01-25228** të datës **03.10.2025**.

II. Menaxheri dhe mbikqyrësat e drejtëpërdrejt të projektit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur, do të raportoj me shkrim ZKA, Zyren e Prokurimit, **DSHPE** mbi realizimin e punëve në teren.

III. Sipas këtij vendimi Menaxherët dhe mbikqyrësat e projektit do të jenë të angazhuar në procesin e implementimit të projektit, bazuar në përgjegjësit sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit Publik.

IV. Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Mbikqyrsi i drejtëpërdrejtë, Zyra e prokurimit , OE dhe **DSHPE**.

Kryetari i komunës
z. Besim Ilazi



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **Mali Art Group SH.P.K. , Kaçanik i Vjetër, Isen Brodi , 190 Kacanik**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Ndertimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike.
Numri i Prokurimit: 652-25-7879-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Njezet e Kater mije e Nent qinde e Njezet e Gjashtedhjetë e Nje 24,920.61 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **24,920.61 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **760** ditë prej **03.10.2025** deri më **02.11.2027**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrim dhe vulë e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.

Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
02.10.2025